



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:150462

Datë: 03.01.2024

Numri i dokumentit: 05150092

**P.nr. 82/2023**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit D. (Z.) Z. nga fshati Ll., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par 1.4 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore - Departamenti i përgjithshëm me aktakuzë PP/II.nr.22/2023, të datës 06.07.2023, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 16.10.2023, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Qazim Kuqi, mbrojtësja e viktimave F. B.- Q., e dëmtuara G. B., si dhe të akuzuarit D. Z., **më 19 tetor 2023, nxjerri dhe publikisht shpalli këtë:**

## **A K T G J Y K I M**

I akuzuari **D.Z.** nga i ati Z., e ëma L., e vajzërisë K., i lindur më ..., nga fshati L., Komuna e Malishevës, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, më parë i pa dënuar, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ....

## **Ë S H T Ë F A J T O R**

### **SEPSE,**

Më datën 03.01.2023 rreth orës 11:00/h, në fshatin L., Komuna e Malishevës, saktësisht në shtëpinë e tyre familjare, i pandehuri me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarës/bashkëshortes së tij G. B., në atë mënyrë që pas disa problemeve të vazhdueshme që kishin mes vete, ditën kritike i pandehuri fillimisht e fyen dhe dhanë në fjalë të ndryshme të dëmtuarën e më pas e sulmon fizikisht duke goditur me grushte, shqelma dhe më një papuçë në pjesë të ndryshme të trupit, pastaj e dëmtuara detyrohet të largohet nga shtëpia e saj dhe shkon tek prindërit e saj, me ç' rast i pandehuri të dëmtuarës i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruara si në akt ekspertimin mjeko-ligjor të dr. A.G. datë 24.01.2023.

- me çka ka kryer veprën lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par 1.4 të KPRK-së.

Gjykata konform nenit 4,6,7,17,38,39,40,42,43,69,70,185 par.1 nën par 1.4 të KPRK-së, si dhe nenit 241,242,364,365,449 par. 1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe 2.6 të Kodit të Procedurës Penale, të njëjtin e gjykon me:

## **DËNIMIN ME KUSHT**

Ashtu që të akuzuarin **D. Z.** e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën kohore prej një (1) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 20,00 €, për shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 50,00 €, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

E dëmtuara G.B. nga fshati C., Komuna M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

## **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzë PP/II.nr. 22/2023, të datës 06.07.2023, kundër të akuzuarit D. Z. nga fshati Ll., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nën par. 1.4 të KPRK-së

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar më 16.10.2023, pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit Qazim Kuqi, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë.

Prokurori i shtetit jep mendimin se: nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe një herë ky pranim gjen mbështetje edhe në provat që e mbështesin aktakuzën, prandaj gjykatës i propozoj që të bëjë pranimin e fajësisë si shprehje të lire të vullnetit, dhe të akuzuarit ti shqiptoj një dënim konform ligjit duke i vlerësuar rrethanat lehtësues siç janë pranimi i fajësisë, pendimi për veprën e kryer, dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryen vepër penale, po ashtu faktin se i njëjti për herë të parë bie ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese të vlerësoj faktin se vepra penale është kryer brenda marrëdhënies familjare.

Mbrojtësja e viktimave F.B. – Q., deklaron se e mbështes deklarimin e palës së dëmtuar nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga i akuzuari.

E dëmtuara G. B., deklaron se: nuk kërkoj që të dënohet i akuzuari dhe nuk kërkoj kompensim dëmi, ne jemi duke jetuar bashkë nga dita e veprës penale, nga dita e veprës penale ne nuk kemi pasur probleme. Ne i kemi dy fëmijë bashkë dhe unë po dua me ja tërheq akuzën bashkëshortit tim.

I pandehuri D.Z., deklarohet i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohem, të dëmtuarës i kërkoj falje, ky është rasti imë i parë që kam kryer vepër penale, i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris vepër tjetër penale, ne jemi duke jetuar së bashku dhe i kemi dy fëmijë së bashku, kërkoj nga gjykata që të më dënoj sa më pak mundësisht më kusht.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestarë u vërtetua se ai me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: raporti fillestar i incidentit nr. ... dt. 03.01.2023; procesverbali i marrjes në pyetje për të dyshuarin D. Z., ... dt. 04.01.2023; procesverbali i marrjes në pyetje për të dëmtuarën G. B. ... dt.04.01.2023; (5) pesë foto dokumentacioni; raporti mjekësor Q.K.M.F në Malishevë, për të dëmtuarën G. B., nr. protokollit 431, dt. 04.01.2023; raporti i policit S. H. ID # .. nr. .... 06.04.2023; raporti ditor i dhunës familjare nr. ..., dt.04.01.2023, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarimin e pranimin të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarimin e pranimin të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që posaçërisht rrethanë lehtësuese ka marr faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, të njëjtën e ka pranuar në mënyrë vullnetare, i kërkoj falje të dëmtuarës, i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris vepër tjetër penale, e dëmtuara nuk ka kërkuar kompensim dëmi dhe nuk ka kërkuar me u dënuar i pandehuri, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk gjeti, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit të parapara me nenin 70 të KPRK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se i akuzuari ka kryer veprën

penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, të akuzuarin e dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër (4) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhë prej një (1) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale me bindjen se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë bazuar në nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së, si dhe bazuar në nenin 36 par. 3 nën par. 3. 1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr.08/L-109.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 364,365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr. 82/2023, më 19 tetor 2023**

**Zyrtarja ligjore,**  
**Albane MORINA**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
**Njazi MORINA**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.